

VENDIM
Nr. 618, datë 20.10.2021

**PËR KRIJIMIN, ORGANIZIMIN E FUNKSIONIMIN E RRJETIT TË
KOORDINATORËVE KUNDËR KORRUPSIONIT**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të nenit 24, të ligjit nr. 90/2012, “Për organizimin dhe funksionimin e administratës shtetërore”, me propozimin e ministrit të Drejtësisë, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

I. DISPOZITA TË PËRGJITHSHME

1. Krijimin e Rrjetit të Koordinatorëve kundër Korrupsionit (në vijim “Rrjeti i Koordinatorëve”), nën drejtimin e ministrit të Drejtësisë, në cilësinë e Koordinatorit Kombëtar kundër Korrupsionit.

2. Rrjeti i Koordinatorëve përbëhet nga koordinatorët kundër korrupsionit (në vijim “koordinatorët”) dhe struktura përgjegjëse kundër korrupsionit në Ministrinë e Drejtësisë.

3. Misioni i Rrjetit të Koordinatorëve është mbledhja, analizimi, koordinimi, verifikimi dhe hetimi administrativ i të gjithë informacionit për rastet korruptive, praktikat abuzive dhe arbitrare, kryesisht nga vetë koordinatori ose struktura përgjegjëse kundër korrupsionit në Ministrinë e Drejtësisë ose, me kërkesë të çdo autoriteti publik ose pale të tretë, duke përfshirë dhe rastet korruptive të referuara nga platforma “Për Shqipërinë që duam” për institucionet, pjesë e Rrjetit të Koordinatorëve, me qëllim parandalimin e goditjen e korrupsionit në institucionet e administratës shtetërore, si dhe vlerësimin e rrezikut kundër korrupsionit e propozimin e masave, të rregullave dhe të procedurave për menaxhimin e këtij rreziku.

II. ORGANIZIMI DHE FUNKSIONIMI I RRJETIT TË KOORDINATORËVE

1. Rrjeti i Koordinatorëve ka në përbërje, në rolin e koordinatorit, përfaqësues nga institucione në nivel qendror e në nivel rajonal.

2. Institucionet, ku shtrihet Rrjeti i Koordinatorëve, në nivel qendror janë:

- Agjencia e Administrimit të Pasurive të Sekuestruara dhe Konfiskuara;
- Agjencia e Blerjeve të Përqendruara;
- Agjencia Kombëtare e Barnave dhe Pajisjeve Mjekësore;
- Agjencia Kombëtare e Bregdetit;
- Agjencia Kombëtare e Burimeve Natyrore;
- Agjencia Kombëtare e Mjedisit;
- Agjencia Kombëtare e Zonave të Mbrojtura;
- Agjencia për Sigurimin e Cilësisë në Arsimin e Lartë;
- Agjencia për Zhvillim Bujqësor dhe Rural;
- Agjencia Shtetërore e Kadastrës;
- *AlbControl* sh.a.;
- *Albpetrol* sh.a.;
- Autoriteti i Aviacionit Civil;
- Autoriteti Kombëtar i Ushqimit;
- Autoriteti Portual Durrës;
- Autoriteti Rrugor Shqiptar;
- Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve;
- Drejtoria e Përgjithshme e Doganave;
- Drejtoria e Përgjithshme e Arsimit Parauniversitar;
- Drejtoria e Përgjithshme e Gjendjes Civile;
- Drejtoria e Përgjithshme e Shërbimeve të Transportit Rrugor;

- Fondi i Sigurimit të Detyrueshëm të Kujdesit Shëndetësor;
- Instituti i Sigurimeve Shoqërore;
- Instituti i Shëndetit Publik;
- Inspektorati Kombëtar për Mbrojtjen e Territorit;
- Inspektorati Shtetëror i Punës dhe Shërbimeve Shoqërore;
- Inspektorati Shtetëror Shëndetësor;
- Inspektorati Shtetëror Teknik dhe Industrial;
- Operatori i Sistemit të Shpërndarjes së Energjisë;
- Operatori i Sistemit të Transmetimit;
- Operatori i Shërbimeve të Kujdesit Shëndetësor;
- Porti Detar Sarandë sh.a.;
- Porti Detar Shëngjin sh.a.;
- Porti Detar Vlorë sh.a.;
- Posta Shqiptare;
- Qendra Spitalore Universitare “Nënë Tereza”;
- Spitali Obstetrik Gjinekologjik “Mbretëresha Geraldinë”;
- Spitali Universitar i Traumës;
- Spitali Universitar Obstetrik Gjinekologjik “Koço Gliozheni”;
- Spitali Universitar “Shefqet Ndroqi”;
- Spitali Psikiatrik “Ali Mihali”, Vlorë;
- Spitali Psikiatrik “Sadik Dinci”, Elbasan;
- Shërbimi Social Shtetëror;
- Korporata Elektroenergjetike Shqiptare sh.a.

3. Institucionet, ku shtrihet Rrjeti i Koordinatorëve, në nivel rajonal janë:

- a) në çdo drejtori vendore të Agjencisë Shtetërore të Kadastrës;
- b) drejtoritë rajonale të Operatorit të Shërbimeve të Kujdesit Shëndetësor;
- c) drejtoritë rajonale të Arsimit Parauniversitar;
- ç) spitalet rajonale.

4. Në institucionet në nivel rajonal, sipas shkronjave “b”, “c” dhe “ç”, të pikës 3, të këtij kreu, caktohen 4 (katër) koordinatorë rajonalë, që mbulojnë një grupim rajonal të institucioneve vendore/degëve territoriale. Grupimi i institucioneve vendore/degëve territoriale, si dhe vendi ku koordinatori rajonal ushtron veprimtarinë e tij, brenda fushës së përgjegjësisë së koordinatorit rajonal, miratohet me urdhër të Koordinatorit Kombëtar kundër Korrupsionit.

5. Në institucionet e administratës shtetërore, entet publike dhe shoqëritë tregtare me kapital shtetëror, pjesë e Rrjetit të Koordinatorëve, krijohet pozicioni “Koordinator i Rrjetit të Koordinatorëve kundër Korrupsionit”, i cili emërohet nga titullari i institucionit, për një afat 2-vjeçar, pas propozimit të Koordinatorit Kombëtar Kundër Korrupsionit.

6. Në institucionet e administratës shtetërore, entet publike dhe shoqëritë tregtare me kapital shtetëror, të përcaktuara në pikën 2, të këtij kreu, pagat e të cilëve miratohen nga një organ i ndryshëm nga Këshilli i Ministrave, niveli i pozicionit “Koordinator i Rrjetit të Koordinatorëve kundër Korrupsionit” është i njëjtë me nivelin e punonjësit më të lartë pas titullarit të institucionit ku është emëruar.

7. Emërimi dhe lirimi nga detyra i koordinatorit bëhet nga titullari i institucionit ose shoqërisë tregtare me kapital shtetëror, sipas propozimit të Koordinatorit Kombëtar kundër Korrupsionit.

8. Koordinatori përgjigjet para Koordinatorit Kombëtar Kundër Korrupsionit për të gjithë veprimtarinë e ushtruar në rolin e koordinatorit.

9. Marrëdhëniet e punës së koordinatorit rregullohen në bazë të dispozitave të Kodit të Punës.

10. Procedurat e përzgjedhjes e të rekrutimit të kandidatëve për koordinator përcaktohen në rregulloren e brendshme të Rrjetit të Koordinatorëve, të miratuar me urdhër të Koordinatorit Kombëtar kundër Korrupsionit.

11. Veprimtaria dhe kryerja e detyrave të koordinatorit monitorohen nga struktura përgjegjëse kundër korrupsionit në Ministrinë e Drejtësisë.

12. Struktura përgjegjëse kundër korrupsionit në Ministrinë e Drejtësisë vë në dijeni Koordinatorin Kombëtar kundër Korrupsionit, në rast se konstaton parregullsi gjatë ushtrimit të detyrave nga koordinatori.

13. Koordinatori Kombëtar kundër Korrupsionit, në varësi të shkeljes së konstatuar, i propozon titullarit të institucionit apo shoqërisë tregtare me kapital shtetëror pezullimin e koordinatorit ose marrjen e masës disiplinore për largimin nga funksioni.

14. Koordinatori raporton për veprimtarinë e kryer prej tij, çdo 3 (tre) muaj, pranë strukturës përgjegjëse kundër korrupsionit në Ministrinë e Drejtësisë dhe sa herë kërkohet nga kjo e fundit.

15. Struktura përgjegjëse kundër korrupsionit në Ministrinë e Drejtësisë, çdo 6 (gjashtë) muaj, kryen vlerësimin e punës së koordinatorëve dhe i raporton Koordinatorit Kombëtar Kundër Korrupsionit.

III. PËRGJEGJËSITË FUNKSIONALE TË RRJETIT TË KOORDINATORËVE

1. Koordinatori ushtron këto detyra:

a) mbledh informacion për veprimtaritë korruptive, praktikat abuzive apo arbitrare nga burime të ndryshme dhe kryen hetime administrative brenda fushës së përgjegjësisë së institucionit apo shoqërisë tregtare me kapital shtetëror;

b) bashkëpunon me strukturat e brendshme të institucionit për shqyrtimin e rasteve të korrupsionit;

c) këshillon, udhëzon e ndërgjegjëson nëpunësit dhe qytetarët për identifikimin e adresimin e rasteve korruptive pranë institucioneve të tyre;

ç) vlerëson rrezikun e korrupsionit në institucionin e administratës shtetërore ku bën pjesë, duke analizuar mundësitë e shfaqjes së formave të veçanta të korrupsionit, në përputhje me llojin e funksioneve publike apo administrative që institucioni ushtron;

d) harton raportin përfundimtar të rastit, objekt verifikimi, dhe e përcjell atë pranë strukturës përgjegjëse kundër korrupsionit në Ministrinë e Drejtësisë;

dh) raporton për punën e performancën e Rrjetit të Koordinatorëve në institucionin përkatës, pranë strukturës përgjegjëse kundër korrupsionit në Ministrinë e Drejtësisë, si dhe harton raportin periodik javor për fazën në të cilën ndodhen rastet në proces;

e) kryen çdo detyrë tjetër të parashikuar në këtë vendim ose të deleguar nga Koordinatori Kombëtar kundër Korrupsionit apo nga struktura përgjegjëse kundër korrupsionit në Ministrinë e Drejtësisë, në përputhje me kompetencat e tij;

ë) në çdo rast, ndjek e raporton pranë strukturës përgjegjëse kundër korrupsionit në Ministrinë e Drejtësisë zbatimin e rekomandimeve të marra nga institucioni përkatës;

f) kërkon hetim të thelluar, sipas rastit, nga struktura përgjegjëse kundër korrupsionit në Ministrinë e Drejtësisë.

IV. ORGANIZIMI DHE FUNKSIONI I STRUKTURËS PËRGJEGJËSE KUNDËR KORRUPSIONIT NË MINISTRINË E DREJTËSISË

1. Struktura përgjegjëse kundër korrupsionit në Ministrinë e Drejtësisë organizohet në nivelin e drejtorisë së përgjithshme dhe drejtohet nga drejtori i përgjithshëm, i cili organizon e drejton të gjithë veprimtarinë e strukturës dhe përgjigjet përpara Koordinatorit Kombëtar kundër Korrupsionit.

2. Metodat e brendshme të punës dhe sjellja e nëpunësve të kësaj strukture përcaktohen në rregulloren e brendshme të Rrjetit të Koordinatorëve, që miratohet me urdhër të Koordinatorit Kombëtar Kundër Korrupsionit.

3. Misioni i strukturës përgjegjëse kundër korrupsionit në Ministrinë e Drejtësisë është kryerja e verifikimit (hetimit administrativ) të denoncimeve/ankesave për praktika abuzive, korruptive apo arbitrare për zbatimin e ligjshmërisë, si dhe identifikimi i punonjësit e institucioneve, pjesë e Rrjetit të Koordinatorëve, të cilët, me veprime apo mosveprime, kanë kryer shkelje të akteve ligjore/nënligjore në fuqi, si dhe njëkohësisht zhvillimi i projekteve dhe i programeve në fushën e

kundër korrupsionit, planifikimi, koordinimi e përcaktimi i instrumenteve të domosdoshme për implementimin e politikave të fushës kundër korrupsionit.

4. Struktura përgjegjëse kundër korrupsionit në Ministrinë e Drejtësisë, me urdhër të Koordinatorit Kombëtar kundër Korrupsionit, kryen verifikime dhe kontrole (hetim administrativ) pranë të gjitha institucioneve, pjesë e Rrjetit të Koordinatorëve.

5. Në rastet e hetimeve të thelluara, për shkak të njohurive të veçanta që kërkon hetimi ose verifikimi i një çështjeje, në grupin e punës së strukturës përgjegjëse kundër korrupsionit në Ministrinë e Drejtësisë mund të përfshihen edhe ekspertë të administratës shtetërore.

6. Në rastin kur është e nevojshme përfshirja e ekspertëve nga administrata shtetërore, Koordinatori Kombëtar kundër Korrupsionit paraqet kërkesën për vendosje në dispozicion të ekspertit/ekspertëve, i cili/të cilët kanë kualifikimet e cilësitë e kërkuara për kryerjen e hetimeve.

7. Titullarët duhet të vendosin në dispozicion ekspertë nga administrata shtetërore, të cilët përmbushin kriteret përkatëse. Ekspertët e administratës shtetërore e ushtrojnë veprimtarinë e tyre nën drejtimin e drejtuesit të grupit të hetimit të thelluar, sipas përcaktimeve të urdhrit të Koordinatorit Kombëtar kundër Korrupsionit dhe brenda afatit të përcaktuar në këtë urdhër.

8. Ekspertët e administratës shtetërore, të angazhuar në hetime të thelluara sipas përcaktimeve të këtij kreu, nënshkruajnë deklaratë konfidencialiteti.

9. Në përfundim të hetimit të thelluar administrativ nga struktura përgjegjëse kundër korrupsionit në Ministrinë e Drejtësisë, hartohet raport përfundimtar, i cili i propozohet për miratim Koordinatorit Kombëtar kundër Korrupsionit.

10. Procedura e hetimit administrativ apo verifikimit nga struktura përgjegjëse kundër korrupsionit në Ministrinë e Drejtësisë kryhet në bazë të kreu V, të këtij vendimi.

11. Struktura përgjegjëse kundër korrupsionit në Ministrinë e Drejtësisë monitoron veprimtarinë e Rrjetit të Koordinatorëve dhe raporton pranë Koordinatorit Kombëtar kundër Korrupsionit.

12. Nëpunësit e strukturës përgjegjëse kundër korrupsionit në Ministrinë e Drejtësisë nënshkruajnë deklaratë konfidencialiteti.

13. Nëpunësit e angazhuar në hetimet e thelluara dhe në monitorimin e Rrjetit të Koordinatorëve pranë strukturës përgjegjëse kundër korrupsionit në Ministrinë e Drejtësisë pajisen me certifikatë sigurie, sipas legjislacionit në fuqi.

14. Struktura përgjegjëse kundër korrupsionit në Ministrinë e Drejtësisë përfaqëson në gjykatë Ministrinë e Drejtësisë për çështjet që lidhen me raportet e marra në cilësinë e Koordinatorit Kombëtar kundër Korrupsionit.

15. Struktura përgjegjëse kundër korrupsionit në Ministrinë e Drejtësisë kryen rolin e koordinatorit kundër korrupsionit në ato struktura kur vendi i koordinatorit mbetet bosh, deri në plotësimin e tij.

V. PROCEDURA E VERIFIKIMIT, ADMINISTRIMI DHE DOKUMENTIMI

1. Koordinator/struktura përgjegjëse kundër korrupsionit në Ministrinë e Drejtësisë kanë pavarësi gjatë verifikimit të rasteve korruptive, praktikave abuzive apo arbitrare.

2. Koordinator/struktura përgjegjëse kundër korrupsionit në Ministrinë e Drejtësisë fillon procedurën e verifikimit kryesisht dhe/ose bazuar në informacione, ankesa apo denoncime, të cilat administrohen nga koordinatori apo përcillen nga burime të ndryshme.

3. Informacionet, ankesat dhe denoncimet anonime trajtohen vetëm në rastet kur të dhënat e paraqitura pranë koordinatorit sigurojnë bazë të mjaftueshme për të filluar procedurën e verifikimit.

4. Për çdo procedurë hetimi apo verifikimi, koordinatori/struktura përgjegjëse kundër korrupsionit në Ministrinë e Drejtësisë hap një dosje të veçantë, e cila përmban çdo dokumentacion të ardhur, të marrë apo të mbledhur, lidhur me praktikën në fjalë. Në përfundim të kontrollit, materiali i dosjes ruhet e administrohet sipas legjislacionit në fuqi për arkivat.

5. Koordinator/struktura përgjegjëse kundër korrupsionit në Ministrinë e Drejtësisë dokumenton çdo sqarim apo shpjegim, që i jepet nga personi denoncues. Për të provuar

shkeljen, koordinatori mund të kërkojë ballafaqimin e personit denoncues me nëpunësin e institucionit, në rastin kur pranon të mos i ruhet anonimat.

6. Në rastet kur denoncimi vjen nga nëpunës të institucionit, i cili kërkon që identiteti i tij të mos zbulohet, koordinatori/struktura përgjegjëse kundër korrupsionit në Ministrinë e Drejtësisë duhet të marrë të gjitha masat e nevojshme për të parandaluar zbulimin e identitetit të tij, edhe nëse nga vlerësimi i rastit nuk konstatohen shkelje.

7. Gjatë verifikimit, koordinatori/struktura përgjegjëse kundër korrupsionit në Ministrinë e Drejtësisë ka të drejtë të mbledhë informacione dhe dokumente, të cilat bëhen pjesë e dosjes së verifikimit.

8. Kur koordinatori/struktura përgjegjëse kundër korrupsionit në Ministrinë e Drejtësisë gjykon se informacionet e faktet e mbledhura mund të tjetërsohen apo do të shërbejnë për të vazhduar procedura të mëtejshme administrative apo penale, kërkon nga subjekti në pyetje origjinalin të dokumenteve që provojnë parregullsitë e konstatuara, sipas rregullave të parashikuara në Kodin e Procedurave Administrative.

9. Nëpunësi, të cilit i është kërkuar dorëzimi i dokumenteve të shkruara dhe/ose materiale të tjera pranë koordinatorit/strukturës përgjegjëse kundër korrupsionit në Ministrinë e Drejtësisë, duhet të sigurojë që materiali i kërkuar t'i dorëzohet koordinatorit menjëherë dhe, në çdo rast, jo më vonë se 3 (tri) ditë pune nga paraqitja e kërkesës.

10. Për çdo rast, kur fillon një procedurë verifikimi, koordinatori/struktura përgjegjëse kundër korrupsionit në Ministrinë e Drejtësisë mban procesverbal me personin përgjegjës, në të cilin përshkruhet gjetja, baza ligjore dhe të dhënat e dokumenteve të verifikuara dhe të administruara për qëllime të verifikimit.

11. Në përfundim të hetimit ose të verifikimit dhe përpara formulimit të raportit përfundimtar, nëpunësit përgjegjës i vihet në dispozicion aktkonstatimi nëpërmjet protokollit apo *email*-it zyrtar dhe i kërkohet të dokumentojë komente, sqarime apo shpjegime, për çështje që lidhen me objektin e verifikimit, si dhe për fakte e rrethana të tjera që kanë lidhje me to brenda 3 (tri) ditëve. Komentet, sqarimet shpjegimet apo dokumentacioni shtesë i nëpunësit përgjegjës bëhet pjesë e dosjes së verifikimit dhe pasqyrohet në raportin përfundimtar. Në rast refuzimi nga nëpunësi përgjegjës për të dhënë sqarime, koordinatori/struktura përgjegjëse kundër korrupsionit në Ministrinë e Drejtësisë dokumenton refuzimin e vijon me hartimin e raportit përfundimtar.

12. Pas përfundimit të procedurës së verifikimit, koordinatori harton raportin përfundimtar të arsyetuar, i cili përmban metodologjinë e verifikimit të kryer, gjetjet, si dhe rekomandimet për ecurinë e trajtimit të rastit dhe e përcjell pranë strukturës përgjegjëse kundër korrupsionit në Ministrinë e Drejtësisë.

13. Në rast se struktura përgjegjëse kundër korrupsionit në Ministrinë e Drejtësisë vlerëson se raporti përfundimtar i hartuar nga koordinatori nuk është i plotë apo ka mangësi në referimin e dokumenteve provuese, kthen praktikën dhe udhëzon koordinatorin për vazhdimin e verifikimeve për rastin.

14. Në rast se struktura përgjegjëse kundër korrupsionit në Ministrinë e Drejtësisë, bazuar në raportin përfundimtar të hartuar nga koordinatori, vlerëson se nuk ka shkelje administrative apo elemente të veprës penale, i propozon Koordinatorit Kombëtar kundër Korrupsionit mbylljen dhe arkivimin e çështjes.

15. Në rast se struktura përgjegjëse kundër korrupsionit në Ministrinë e Drejtësisë, bazuar në raportin përfundimtar të hartuar nga koordinatori, vlerëson se ka shkelje administrative, i propozon Koordinatorit Kombëtar kundër Korrupsionit miratimin e raportit dhe përcjelljen e tij pranë drejtuesit të institucionit përgjegjës.

16. Në rastin kur raporti përfundimtar i hartuar nga koordinatori përmban elemente të veprës penale, struktura përgjegjëse kundër korrupsionit në Ministrinë e Drejtësisë i propozon Koordinatorit Kombëtar kundër Korrupsionit përcjelljen e çështjes në organin e Prokurorisë, së bashku me të gjithë dokumentacionin e administruar.

17. Gjatë procesit të verifikimit, administrimit dhe dokumentimit, për çështjet që nuk parashikohen në këtë vendim, koordinatori/struktura përgjegjëse kundër korrupsionit në Ministrinë e Drejtësisë respekton parimet e përgjithshme dhe dispozitat e Kodit të Procedurave Administrative.

VI. BASHKËPUNIMI

1. Koordinatori Kombëtar kundër Korrupsionit raporton drejtpërdrejt para Kryeministrit për veprimtarinë e Rrjetit të Koordinatorëve sa herë kërkohet nga ky i fundit, si dhe me kërkesën e Kryeministrit, nëpërmjet strukturës përgjegjëse kundër korrupsionit në Ministrinë e Drejtësisë, kryen të gjithë procedurën e hetimit administrativ të përcaktuar në këtë vendim, në ministritë e linjës.

2. Struktura përgjegjëse kundër korrupsionit në Ministrinë e Drejtësisë bashkëpunon me Agjencinë për Dialog dhe Bashkëqeverisje dhe/ose çdo platformë tjetër të ankesave publike *online*.

3. Struktura përgjegjëse kundër korrupsionit në Ministrinë e Drejtësisë bashkëpunon e merr informacion nga njësitë e vetëqeverisjes vendore dhe kryen të gjithë procedurën e hetimit administrativ të përcaktuar në këtë vendim për raste korruptive.

4. Koordinatori Kombëtar kundër Korrupsionit lidh marrëveshje bashkëpunimi, me qëllim luftën kundër korrupsionit, me Inspektoratin e Lartë të Deklarimit dhe Kontrollit të Pasurive dhe Konfliktit të Interesave, Prokurorinë e Përgjithshme, Prokurorinë e Posaçme, Agjencinë e Prokurimit Publik, Drejtorinë e Përgjithshme për Parandalimin e Pastrimit të Parave, Kontrollin e Lartë të Shtetit, si dhe çdo institucion tjetër të administratës publike, sipas fushave të përgjegjësisë, për nxitjen e bashkëpunimit për çështje të luftës kundër korrupsionit.

5. Struktura përgjegjëse kundër korrupsionit në Ministrinë e Drejtësisë bashkëpunon me struktura të vendeve të tjera, përgjegjëse për çështjet kundër korrupsionit, sipas marrëveshjeve të lidhura për këtë qëllim. Në këtë rast, marrëveshjet bëhen nëpërmjet ministrit të Drejtësisë.

6. Rrjeti i Koordinatorëve/struktura përgjegjëse kundër korrupsionit në Ministrinë e Drejtësisë asistohen në veprimtarinë e tyre nga stafi i strukturave të administratës shtetërore, ku zhvillojnë hetimin administrativ.

7. Institucionet dhe njësitë organizative, pjesë e Rrjetit të Koordinatorëve, vendosin në dispozicion të koordinatorit/strukturës përgjegjëse kundër korrupsionit të gjitha aktet e materialet e kërkuara ose kopje të njësuara me origjinalin e tyre në kohën dhe në mënyrën e kërkuar. Në rastet kur informacioni i kërkuar është i klasifikuar, marrja dhe përdorimi i tij bëhen sipas legjislacionit në fuqi për informacionin e klasifikuar “sekret shtetëror”.

8. Institucionet, pjesë e Rrjetit të Koordinatorëve, bashkëpunojnë me koordinatorin dhe asistojnë atë për përmbushjen e misionit dhe realizimin e qëllimit për të cilin është krijuar Rrjeti i Koordinatorëve, si dhe krijojnë infrastrukturën e nevojshme për aksesin e qytetarëve pranë zyrës së koordinatorit, sipas orareve të përcaktuara nga këta të fundit.

9. Koordinatorit i krijohet akses në bazën e të dhënave të institucionit dhe shoqërisë tregtare me kapital shtetëror pranë të cilit ushtron detyrën, në të njëjtin nivel me punonjësit e auditimit të brendshëm apo të strukturave kundër korrupsionit.

10. Mosdhënia e informacionit të kërkuar, pengimi i koordinatorit/strukturës përgjegjëse kundër korrupsionit në Ministrinë e Drejtësisë në kryerjen e detyrave dhe çdo shkelje lidhur me dhënien e dokumentacionit apo të informacionit të kërkuar përbën shkak për të propozuar fillimin e procedimit disiplinor ndaj nëpunësit përgjegjës dhe, në rast të përsëritur, informohet institucioni epror për marrjen e masave përkatëse.

11. Mosfillimi i procedurave për ndjekjen e rekomandimeve dhe masave të propozuara nga Koordinatori Kombëtar kundër Korrupsionit përbën shkak për të propozuar fillimin e procedimit disiplinor të titullarit përgjegjës nga institucioni epror, ku institucioni përgjegjës ka varësinë.

VII. DISPOZITA TË FUNDIT DHE KALIMTARE

1. Vendimi nr. 209, datë 26.2.2020, i Këshillit të Ministrave, “Për ngritjen dhe funksionimin e njësisë speciale antikorrupsion dhe antievazion”, shfuqizohet.

2. Vendimi nr. 94, datë 15.2.2006, i Këshillit të Ministrave, “Për miratimin e rregullores për funksionet dhe procedurat e kontrollit të brendshëm administrativ dhe antikorrupsion të Këshillit të Ministrave”, shfuqizohet.

3. Në vendimin nr. 247, datë 20.3.2015, të Këshillit të Ministrave, “Për miratimin e strategjisë ndërsektoriale kundër korrupsionit 2015-2023”, të ndryshuar, të bëhen këto ndryshime:

a) Pikat 5, 6, 7, 8, 9, 10 e 12 shfuqizohen;

b) Kudo në anekset 1 dhe 2, bashkëlidhur këtij vendimi, fjalët “... Task-Forcës Ndërinstitucionale Antikorrupsion ...” hiqen.

4. Urdhri nr. 106, datë 25.7.2019, i Kryeministrit, “Për krijimin, përbërjen dhe funksionimin e Rrjetit të Koordinatorëve Antikorrupsion”, i ndryshuar, shfuqizohet.

5. Ngarkohen institucionet e administratës shtetërore dhe shoqëritë tregtare me kapital shtetëror, pjesë e Rrjetit të Koordinatorëve, të fillojnë procedurën për ndryshimet në strukturat dhe organikat e tyre, me qëllim përfshirjen në to të pozicionit “Koordinator i Rrjetit të Koordinatorëve kundër Korrupsionit”. Procedura e miratimit të strukturave dhe organikave të këtyre institucioneve të përfundojë jo më vonë se 3 (tre) muaj nga hyrja në fuqi e këtij vendimi.

6. Ngarkohen Ministria e Drejtësisë, Koordinatori Kombëtar kundër Korrupsionit, koordinorët e Rrjetit të Koordinatorëve kundër Korrupsionit, Kryeministria, ministritë e linjës, si dhe institucionet e administratës shtetërore dhe shoqëritë tregtare me kapital shtetëror, pjesë e Rrjetit të Koordinatorëve, për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTËR
Edi Rama